

## 2.3 REGJISTRIMET E NJËSUARA

Kontrolli i njësuar mundëson përdorimin e qëndrueshëm të pikëqasjeve dhe emërtimeve lëndore në procesin e katalogimit, si dhe mirëmbajtjen më të lehtë të tyre në regjistrimet bibliografike. Kontrolli i njësuar është thelbësor në lidhjet midis regjistrimeve bibliografike dhe atyre të njësuara. Regjistrimet e njësuara përmbajnë pikëqasje, që janë të përcaktuara në mënyrë uniforme për t'u përdorur në të gjithë sistemin e katalogimit të përbashkët, si dhe të dhëna të tjera siç janë variantet e pikëqasjeve, pikëqasjet në lidhshmëri, shënimet etj. Ndryshimi i formave të njësuara, shtimi i varianteve ose të dhënave të tjera në katalogimin me kontroll të njësuar është i mundur vetëm në regjistrimet e njësuara.

Kontrolli i njësuar për momentin është vendosur vetëm për emrat vetjakë dhe emrat e organizatave, të cilët në regjistrimet bibliografike janë të shënuar si autorë.

Për emrat vetjakë, regjistrime të shkurtra me numër të kufizuar të fushave mund të krijojnë të gjithë kataloguesit, të cilët kanë autorizimet për krijimin e regjistrimeve bibliografike. Ndërsa për krijimin e regjistrimeve të plota të njësuara për emrat vetjakë ose të organizatave duhet autorizim i veçantë. Kataloguesi, i cili ka autorizimin për krijimin e plotë të regjistrimeve të njësuara, mund të marr përgjegjësinë për regjistrimin e njësuara dhe në këtë mënyrë ta bllokoi atë. Regjistrimin e tillë mund ta redaktojnë më vonë vetëm kataloguesit nga biblioteka, e cila e ka bllokuar atë. Kjo procedurë përdoret në regjistrimet për emrat vetjakë dhe të organizatave, të cilët i njihni mirë.

Redaktimin SGC e kryen bordi redaktues i listës së emërtimeve lëndore, ndërsa kataloguesit mund të kontribuojnë me propozimet e tyre për plotësime.

Për harmonizimin e bazave bibliografike të të dhënave me bazën e njësuar të të dhënave CONOR dhe SGC përdoret një program i veçantë. Nëse në regjistrimin e njësuar CONOR ndryshoni pikëqasjen e njësuar, variantet e pikëqasjeve ose pikëqasjen në lidhshmëri, apo në regjistrimin e njësuar SGC ndryshoni pikëqasjen e njësuar, fushat në regjistrimet bibliografike në mënyrë automatike ndryshojnë në COBIB, ndërsa me kërkesën e bibliotekës së veçantë edhe në bazën lokale të të dhënave (shih kap. 9.12 dhe kap. 10.5).